



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 6018 Prot.

Tiranë, më 06 . 10 . 2022

REKOMANDIM

MBI

MËNYRËN E HARTIMIT TË RAPORTIMIT TË ZBATIMIT TË KONTRATAVE

Drejtuar: Autoriteteve/enteve kontraktore

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP"), në ushtrim të detyrave të saj sipas parashikimeve në nenin 23, gërma "b" dhe "ç", të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" (në vijim "LPP"), me qëllim mirëzbatimin e kuadrit ligjor për prokurimin publik që lidhet me zbatimin e kontratave, në përfundim të hetimit administrativ sipas Planit të Monitorimit, si dhe duke u nisur nga mangësitë dhe problematikat e evidentuara në formularët e raportimit për zbatimin e kontratave të dërguara, nga autoritetet kontraktore në formë shkresore apo elektronike, rekomandon si më poshtë vijon:

1. APP ka konstatuar se disa autoritete kontraktore (në vijim "AK") kryejnë raportimin e zbatimit të kontratës nëpërmjet formularit të vjetër të raportimit. Sjellim në vëmendjet të AK që raportimi i ecursisë së zbatimit të kontratës duhet të realizohet **sipas formularit standard, të miratuar** me Udhëzimin e APP-së, Nr. 2 datë 18.03.2022" Mbi raportimin e zbatimit të kontratës", në të cilin duhet plotësuar i gjithë informacioni i kërkuar sipas seksioneve përkatëse.
2. Gjatë hartimit të formularit të raportimit të zbatimit të kontratës, disa AK nuk specifikojnë llojin e raportimit, nëse është një raportim përmbledhës, ku është parashikuar raportimi përfundimtar i zbatimit të kontratës, apo janë në kushtet e raportimit të ndërmjetëm. Nga informacioni i paraqitur nuk mund të evidentohet ky fakt. Sjellim në vëmendje të AK, se rastet e raportimit dhe

informacioni që duhet përfshirë në to, parashikohen në pikën 4 dhe 5, të Udhëzimit Nr. 2, datë 18.03.2022” Mbi raportimin e zbatimit të kontratës”. Konkretisht, sipas pikës 4, të këtij udhëzimi:

*“Gjatë zbatimit të kontratës, personi ose strukturat e ngarkuara për ndjekjen e kontratës përgatisin një raport të ndërmjetëm sa herë evidentohen situata dhe problematika të ndryshme, që ndikojnë në zbatimin e kontratës sipas termave dhe kushteve të saj, apo sipas kushteve të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe në legjislacionin në fuqi”.*

*Në raportin e ndërmjetëm përfshihen:*

- a) informacioni mbi të dhënat e kontratës, të tilla si Nr. Prot datë, datën e lidhjes së kontratës, datën e hyrjes në fuqi, kohëzgjatjen, vlerën, sigurimin e kontratës, nëse ka fond rezervë, nëse është kontratë në bazë të një marrëveshje kuadër, numrin e referencës së procedurës/lotit të përfunduar me nënshkrimin e kësaj kontrate, tipin e kontratës, kontraktori/ët, nënkontraktori, mbikëqyrësi dhe koluudatori për kontratat e punëve;*
- b) situatat konkrete të evidentuara gjatë zbatimit, sipas rastit, të tilla si modifikimet e kontratës, ndërprerja, përfundimi apo shpallja e pavlefshme e kontratës, si dhe arsyet, rrethanat dhe argumentimi përkatës, mbi bazën e dispozitave ligjore që është bërë modifikimi, ndërprerja, përfundimi, apo shpallja e pavlefshme e kontratës;*
- c) problematika të tjera të evidentuara, gjatë zbatimit të kontratës, si dhe masat dhe veprimet e ndërmarra nga autoriteti/enti kontraktor në lidhje me problematikat e evidentuara.*

Ndërsa, në pikën 5, të këtij udhëzimi, përcaktohet se: *“Në përfundim të kontratës, personi ose strukturat e ngarkuara për ndjekjen e kontratës përgatisin raportin përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës.*

*Në raportin përmbledhës përfshihet:*

- a) informacioni mbi të dhënat e kontratës, sipas përcaktimeve të shkronjës “a”, të pikës 4, të këtij udhëzimi;*
- b) informacioni mbi të gjitha situatat apo problematikat e hasura gjatë zbatimit dhe masat e marra për zgjidhjen e tyre, nëse është rasti;*
- c) informacioni nëse kontrata është zbatuar me korrektësi dhe cilësi;*
- d) informacioni në lidhje me parashikimet e kontratës për kryerjen e pagesave dhe informacioni për likuidimin ose jo të kontratës.”.*

3. Në rastin e kontratave të lidhura në bazë të një marrëveshjeje kuadër, në disa raste, AK raportojnë në të njëjtën kohë për të gjitha minikontratat e lidhura në përfundim të afatit të marrëveshjes kuadër. Sjellim në vëmendje të AK që raportimi i zbatimit të kontratës duhet bërë periodikisht për çdo minikontratë që është lidhur në bazë të marrëveshjes kuadër, pas përfundimit të zbatimit të saj.

4. Në seksionin I të formularit, në pikën A “Të dhënat e kontratës”, disa autoritete kontraktore, në kontratat e punëve publike, nuk raportojnë datën konkrete të hyrjes në fuqi të kontratës, por e lidhin

hyrjen në fuqi të kontratës me situata të tjera, si p.sh. dorëzimi i sheshit të ndërtimit, marrja e lejeve përkatëse etj. Sjellim në vëmendje të AK, se në formular, te të dhënat e kontratës, data e hyrjes në fuqi të kontratës duhet të jetë data konkrete e parashikuar në të cilën kontrata hyn në fuqi, në bazë të të cilës llogariten afatet e zbatimit të saj.

Ndërkohë, AK duhet të marrin paraprakisht të gjitha masat e nevojshme, për lirim të sheshit të ndërtimit dhe disponimin e kantierit brenda afatit të parashikuar në dokumentet e tenderit dhe në kontratë, si dhe për kryerjen e procedurave për marrjen e lejeve që janë të nevojshme për kryerjen e objektit të kontratës.

5. Në seksionin I, pika A “Të dhënat e kontratës”, disa autoritete kontraktore nuk plotësojnë të gjitha të dhënat e tabelës, si p.sh nuk evidentojnë faktin nëse kontrata është lidhur në bazë të një marrëveshjeje kuadër (Minikontratë), nuk plotësohet numri i referencës së procedurës së prokurimit, tipi i kontratës (mall, shërbim apo punë), apo kontraktori ose bashkimi i operatorëve ekonomikë (nëse është rasti) me të cilin kanë lidhur kontratën objekt raportimi. Sjellim në vëmendje të AK, se në formular duhet të plotësohen të gjitha të dhënat sipas seksioneve respektive, në mënyrë të saktë e të qartë.

6. APP ka konstatuar se në shumë kontrata AK raportojnë modifikimin e afatit të kontratës, i cili është një nga elementët kryesorë të një kontrate dhe modifikimi i tij bëhet vetëm nëse AK ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 127, të LPP. Gjithashtu, çdo modifikim i kontratës apo marrëveshjes kuadër duhet të bazohet në parashikimet e këtij neni.

Ndërkohë, në formularin e raportimit, AK duhet të përshkruajnë shkurtimisht arsyet, rrethanat dhe argumentimin përkatës, mbi bazën e dispozitave ligjore që është bërë modifikimi i kontratës. Në çdo rast, AK duhet të mbajnë në konsideratë që arsyet dhe argumentimet për modifikimin e kontratës ose të marrëveshjes kuadër duhet të dokumentohen nga autoriteti ose enti kontraktor.

7. Në seksionin II, pika B2, “Ndërprerje e kontratës”, disa autoritete kontraktore plotësojnë të dhënat mbi modifikimet e kontratës gjatë zbatimit të tyre (si shtyrja e afatit për shkak të pezullimit të punimeve apo çdo rrethanë tjetër që ka sjellë modifikim të kontratës), dhe i raportojnë ato si ndërprerje të kontratës. Sjellim në vëmendje të AK që kur kanë pezullim të punimeve dhe si rezultat i këtij pezullimi kanë shtyrë afatin e zbatimit të kontratës, nëpërmjet modifikimit të saj bazuar në parashikimet e nenit 127, të LPP, atëherë AK duhet të plotësojnë pikën B1, të formularit, duke pasqyruar modifikimin e kryer, si dhe arsyet, rrethanat dhe argumentimin përkatës për modifikimin.

Ndërkohë, pika B2 “Ndërprerje e kontratës” duhet të plotësohet vetëm në rastet e ndërprerjes përfundimtare të kontratës, si psh rasti i ndërprerjes së parakohshme të kontratës sipas nenit 118, pika 3/b të LPP, ku parashikohet se:

*“Pas lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit ose entit kontraktor është në kundërshtim me ndonjë nga dispozitat e këtij ligji, ka të drejtë:*

*b) të urdhërojë autoritetin kontraktor për shkurtimin e kohëzgjatjes së kontratës dhe të kërkojë ndërprerjen e parakohshme të saj;”*

8. Në seksionin II, pika B3 të formularit, “Përfundimi i kontratës para afatit”, disa autoritete kontraktore përcaktojnë vetëm datën e përfundimit të kontratës, ndërkohë që në këtë seksion duhet të përshkruajnë shkurtimisht edhe arsyet, rrethanat dhe argumentimin përkatës, mbi bazën e dispozitave ligjore që është bërë përfundimi i kontratës para afatit të saj.

9. Në seksionin II, pika B8 të formularit, në lidhje me plotësimin e datës së përfundimit të kontratës, disa AK vendosin si datë përfundimi të saj datën e përllogaritur në përfundim të afatit maksimal brenda të cilit duhet të realizohet zbatimi i kontratës, që në disa raste rezulton pas datës së raportimit. Sjellim në vëmendje të AK, që në këtë seksion, AK duhet të raportojnë datën faktike të përfundimit të kontratës dhe jo datën e përllogaritur në përfundim të afatit maksimal për zbatimin kontratës.

10. Në seksionin II, pika C “Likujdimi i kontratës”, në lidhje me parashikimin në kontratë për afatin e shlyerjes së pagesave, një masë e konsiderueshme autoritetesh kontraktore nuk i japin vëmendjen e duhur duke e lënë të paplotësuar këtë pikë. Gjithashtu, disa autoritete kontraktore deklarojnë që pagesa do të bëhet brenda një date të caktuar, të mëvoshme ose brenda vitit kalendarik etj. Në vijim të problematikave të konstatuara më sipër, APP thekson se kjo pikë duhet raportuar në përputhje të plotë dhe sipas parashikimeve të vendosura në kontratë në lidhje me afatin e shlyerjes së pagesave, të cilat duhet të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

11. Autoritetet kontraktore duhet të raportojnë datën e kolaudimit të punimeve (për kontratat e punëve publike). Në shumë raste, kjo e dhënë nuk plotësohet nga AK, ose raportohet që do realizohet në vijimësi ose në proces. Në shumë raste, nga raportimet rezultojnë se kolaudimi është kryer disa muaj më vonë se data e përfundimit të punimeve. Sjellim në vëmendje të AK, që në caktimin e kolaudatorit të punimeve duhet të mbajnë në konsideratë parashikimet e legjislacionit të posaçëm në fushën e ndërtimit. Konkretisht, në pikën 2, të Kreut II, të Udhëzimit Nr. 3, datë 15.02.2001, i ndryshuar, parashikohet se *“Kolaudatori ose grupi i kolaudimit caktohet nga investitori, i cili duhet t’ia komunikojë, me shkrim, këtë person apo grup personash Sekretariatit Teknik të KRRT-së, pranë zyrës dhe seksionit urbanistik përkatës në rreth, brenda 30 ditëve nga*

*data e përfundimit të punimeve. Punëdhënësi duhet të përcaktojë, gjithashtu, në marrëveshje me mbikëqyrësin dhe kolaudatorin (ose grupin e kolaudimit), mënyrën dhe afatet e procesit të kolaudimit?*

Për sa më sipër, sjellim në vëmendje të AK që duhet të marrin masa në kohë për zhvillimin e procedurave të prokurimit për caktimin e kolaudatorit të punimeve, me qëllim respektimin e parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe me qëllim finalizimin me sukses të kontratës së punës publike.

12. Një ndër problematikat më të konstatuara gjatë raportimit të zbatimit të kontratave, lidhet me datën e shlyerjes së plotë të detyrimit financiar. Në lidhje me këtë problematikë, disa AK raportojnë datën e faturës, duke e lënë të paqartë nëse kjo datë është data e shlyerjes së detyrimit financiar, apo vendosin numrat e një apo më shumë faturave me datat respektive të tyre, duke krijuar konfuzion në lidhje me statusin e pagesës së tyre. Sjellim në vëmendje të AK që në këtë pikë duhet raportuar data e shlyerjes faktike të detyrimit financiar, bazuar në dokumentet financiarë që vërtetojnë shlyerjen e tyre dhe jo datat e parashikuara për shlyerjen apo afatet maksimale, apo datat e parashikuara kur duhet të realizohet shlyerja.

Theksojmë se kryerja e pagesave është një nga detyrimet kryesore që kanë autoritetet kontraktore gjatë zbatimit të kontratave dhe në lidhje me to duhet të respektojnë kushtet e kontratës, si dhe legjislacionin e aplikueshëm në fuqi.

13. Në shumë raste, AK raportojnë një problematikë që kanë hasur gjatë zbatimit të kontratës, por nuk raportojnë në lidhje me masat që kanë marrë për zgjidhjen e kësaj problematike. Sjellim në vëmendje që pas konstatimit të një problematike gjatë zbatimit të një kontrate, AK duhet të marrin të gjitha masat dhe veprimet e nevojshme për zgjidhjen e problematikës, të cilat duhet të pasqyrohen në formularin e raportimit.

14. Sjellim në vëmendje të AK që raportimet lidhur me ecurinë e zbatimit të kontratës (raportet e ndërmjetme dhe përmbledhëse) hartohet nga personi apo strukturat e ngarkuara për ndjekjen e kontratës, të cilët i përcjellin te personi përgjegjës për prokurimin, me qëllim dërgimin pranë APP-së. Për rrjedhojë, këto raporte duhet të jenë të nënshkruara nga personi/personat përgjegjës për ndjekjen e kontratës.

15. Së fundmi, APP ka konstatuar se një pjesë e konsiderueshme autoritetesh kontraktore raportojnë ecurinë e zbatimit të kontratave dhe dërgojnë formularin jashtë afateve ligjore të parashikuara. Në pikën 6 të nenit 107 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, përcaktohet se: *"Në përfundim të kontratës, personi ose strukturat e ngarkuara për ndjekjen e kontratës përgatisin një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, problemet e hasura gjatë*

*zbatimit dhe masat e marra për zgjidhjen e tyre, nëse është rasti, si dhe paraqet një informacion për likuidimin ose jo të kontratës. Një kopje e këtij raporti i dërgohet APP-së **jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga përfundimi i kontratës**, si dhe mund t'i vihet në dispozicion kontraktorit, me kërkesë të tij, nga personi/at përgjegjës për prokurimin”*

Sa më sipër, në zbatim të parashikimeve ligjore AK duhet të dërgojnë formularët e raportimit të zbatimit të kontratës, **pranë APP-së, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga përfundimi i kontratës.**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Reida Kashta**

